



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 22 Datë 18.02.2013

MBI

**KERKESEN PER MIRATIM TE SKEDULIMIT TE PAGESAVE TE CEZ
SHPERNDARJE SH.A (NE ADMINISTRIM TE PERKOHSHEM)**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimin nr. 5, date 21.01.2013, “Për vendosjen e shoqerise CEZ shperndarje sh.a, ne administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqerise cez shperndarje sh.a., në zbatim të vendimit të bordit të komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 janar 2013, “Per heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjise elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakice të energjise elektrike të shoqerise CEZ Shperndarje sh.a.”, Rregullores “Per procedurat e emerimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.02.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike të ERE,

Vendosi:

1. Miratimin e skedulimit të pagesave të CEZ Shperndarje (bashkelidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftoje shoqerine CEZ Shperndarje për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-se.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI